SHQIPËRIA NË SHIFRA

2015

Drejtor Botimi: **Dr. Mirela Muça**

Përpunimi Statistikor: **INSTAT**

Copyright © INSTAT 2016

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.


Përpunimi në kompjuter: **Mariana Vllau**

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Bul. "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 228300
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Përmbajtja

Demografia	7
Statistika Juridike	11
Vendimmarrja	13
Arsimimi dhe Njohuritë	15
Kultura	18
Papunësia	19
Punësimi	20
Statistikat e Konsumit të Familjeve	21
Çmimet dhe Konsumi	23
Regjistri i Ndërmarrjeve	24
Tregtia me Pakicë	25
Tregtia e Jashtme	26
Transporti	27
Turizmi	28
Llogaritë Kombëtare	29

HARTA ADMINISTRATIVE TERRITORIALE E SHQIPËRISË



BASHKITË

01 BERAT
02 URA VAJGURORE
03 KUÇOVË
04 SKRAPAR
05 POLIÇAN
06 DIBËR
07 BULQIZË
08 MAT
09 KLOS
10 DURRËS
11 SHIJAK
12 KRUJË
13 ELBASAN
14 CËRRIK
15 BELSH
16 PEQIN
17 GRAMSH
18 LIBRAZHD
19 PRRENJAS
20 FIER
21 LUSHNJE
22 PATOS
23 ROSKOVEC
24 DIVJAKË
25 MALLAKASTËR
26 GJIROKASTËR
27 LIBOHOVË
28 PËRMET
29 KËLCYRË
30 TEPELENË
31 MEMALIAJ
32 DROPULL
33 KORÇË
34 POGRADEC
35 MALIQ
36 PUSTEC
37 KOLONJË
38 DEVOLL
39 KUKËS
40 TROPOJË
41 HAS
42 LEZHË
43 MIRDITË
44 KURBIN
45 SHKODËR
46 VAU I DEJËS
47 MALËSI E MADHE
48 PUKË
49 FUSHË ARRËS
50 TIRANË
51 KAMËZ
52 VORË
53 KAVAJË
54 RROGOZHINË
55 VLORË
56 HIMARË
57 SARANDË
58 KONISPOL
59 DELVINË
60 FINIQ
61 SELENICË


Kufijtë e bashkive janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësive lokale.

Populllsia mesatare banuese në vitin 2015 shënon një rënie prej 5.300 banorësh në krahasim me vitin 2014. Në vitin 2015 populllsia mesatare banuese në vitin 2015 ka shënuar një rënie prej 0,18 % në krahasim me atë të vitit 2014.


Dy komponentët kryesorë përbërës të populllsisë janë: shtesa natyrore e populllsisë dhe migracioni neto. Shtesa natyrore e populllsisë është zvogëluar në krahasim me një vit më parë me rreth 31 %, si rezultat i uljes së numrit të lindjeve me 8,5 % dhe rritjes së numrit të vdekjeve me 8,5 % krahasuar me vitin 2014.

Nga ana tjetër komponenti i dytë, migracioni neto shënon vlerën prej -17,000 gjatë vitit 2015, duke dhënë kështu një impakt të konsiderueshëm në zvogëlimin e populllsisë.

POPULLSIA DHE NORMA E RRITJES VJETORE, 2001-2015



LINDJE, VDEKJE DHE MIGRACIONI NETO, 2010-2015



Gjatë vitit 2015 numri i lindjeve është zvogëluar me 8,5 % krahasuar me vitin 2014.


8 Demografia

Piramida e popullsisë jep një pamje të qartë të popullsisë sipas grup-moshës dhe gjinisë. Grafiku pasqyron piramidat e popullsisë për dy vite 2005 dhe 2015. Gjatë kësaj periudhe 10-vjeçare vihet re qartë një tendencë drejt plakjes së popullsisë - zvogëlim i bazës së piramidës si rezultat i uljes së numrit të lindjeve dhe rritje në pjesën e sipërme të piramidës si rezultat i rritjes së jetëgjatësisë.
Në vitin 2015, në totalin e popullsisë mesatare të Shqipërisë të rinjtë (0-14 vjeç) zënë 18,1%, ndërsa të moshuarit (65+ vjeç) zënë 12,6 % të popullsisë gjithsej.


Raporti i varësisë së të moshuarve llogaritet si raport i popullsisë 65 vjeç e lartë ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç; për vitin 2015 ky raport në Shqipëri është 18,2 % kundrejt 12,0 % në vitin 2001. Ky raport shpreh një tendencë në rritje me kalimin e viteve. Raporti i varësisë së të rinjve llogaritet si raport i popullsisë 0-14 vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç. Ky raport për vitin 2015 është 26,1 % kundrejt 46,5 % në vitin 2001. Vihet re qartë një rënie e këtij raporti në vendin tonë, pothuajse në përgjysmimin e tij.
Raporti i përgjithshëm i varësisë tregon tendecë në rënie, kjo pasi rënia në raportin e varësisë së të rinjve ka një efekt më të madh se rritja e raportit të varësisë së të moshuarve. Pra, pesha që duhet të përballojnë personat në moshë pune, për suportin e të rinjve dhe të moshuarve është zvogëluar nga 58,5 % në vitin 2001 në 44,3 % në vitin 2015.

Popullsia e Shqipërisë drejt plakjes, nga 7,6 % të moshuar në vitin 2001 sot kemi 12,6 % të moshuar.

PIRAMIDA E POPULLSISË, 2015



RAPORTET E VARËSISË MOSHORE, 2001-2015



TREGUES KRYESOR PËR POPULLSINË E SHQIPËRISË

	Njësia	2013	2014	2015
Jetëgjatësia	**vite**			
Meshkuj		76,0	76,4	76,1
Femra		80,3	80,3	79,7
Indeksi sintetik i fekonditetit	për grua	**1,76**	**1,78**	**1,7**
Mosha mesatare në lindje	vite	**27,3**	**27,2**	**27,2**
Martesat	për 1000 banorë	8,2	8,2	8,7
Divorcet		1,3	1,5	1,8

Shqiptarët sot jetojnë mesatarisht 1 vit më shumë krahasuar me vitin 2011. Në vitin 2015 jetëgjatësia për femrat është 79,7 vjet dhe 76,1 vjet për meshkujt. Ndryshe nga trendi i përgjithshëm 2011-2015, krahasuar me vitin 2014 vihet re një rënie e lehtë e jetëgjatësisë në lindje për të dyja gjinitë.

Indeksi sintetik i fekonditetit vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit (2.1 fëmijë për grua). Në vitin 2015 numri mesatar i fëmijëve për grua është 1.7, duke shënuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2014, ku ky indeks ishte 1.78 fëmijë për grua.

INDEKSI SINTETIK I FEKONDITETIT
Numri mesatar i fëmijëve që një grua mund të lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese 15-49 vjeç.
JETËGJATËSIA MESATARE NË LINDJE
Numri mesatar i viteve që një i lindur sot pritet të jetojë, duke marrë parasysh normat korrente të vdekshmërisë.


Shqiptarët sot jetojnë mesatarisht 1 vit më shumë krahasuar me vitin 2011.

10 Demografia

Koeficienti bruto i martesave ka patur luhatje përgjatë viteve 2001-2015, nga një vlerë minimale 6,9 në vlerë maksimale 9,0 martesa per 1.000 banorë. Krahasuar me vitin 2014 koeficenti bruto i martesave për vitin e fundit ka pësuar një rritje të lehtë (8,2 në 8,7). Viti 2015 karakterizohet nga 8,7 martesa për 1.000 banorë. Mosha mesatare në martesë si për meshkujt dhe për femrat nuk ka ndryshuar shumë përgjatë viteve. Në vitin 2015 mosha mesatare në martesë për meshkujt është 29.6 vjeç dhe për femrat 24.1 vjeç. Vihet re një rritje e lehtë e moshës në martesë për të dyja gjinitë gjatë 2 viteve të fundit.

Divorcet kanë pësuar një rritje drastike nga viti 2001 në vitin 2015 përkatësisht nga 9,6 në 21,0 divorce për 100 martesa. Viti 2015 shënon vlerën dhe normën më të lartë të divorceve ndër vite përkatësisht 5.255 divorce dhe 21,0 divorce për 100 martesa.


KOEFICIENTI BRUTO I MARTESAVE, 2001-2015



MOSHA MESATARE E MARTESËS SIPAS GJINISË

Vitet	Meshkuj	Femra
2013	29,3	23,7
2014	29,5	24,0
2015	29,6	24,1

NORMA E DIVORCEVE PËR 100 MARTESA



Në vitin 2015 ka patur mbi 1.200 martesa më shumë se në vitin 2014.

VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA

	2013	2014	2015
Vepra të evidentuara	**19.930**	**26.910**	**30.584**
Kundër personit	**489**	**398**	**397**
Vrasjet	112	104	59
Vrasje e mbetur në tentativë	206	156	138
Krime seksuale	**87**	**97**	**137**
Krime në fushën e drogës	**1.105**	**1.243**	**1.021**
Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	948	1.123	938
Krime Ekonomike-Financiare	**2.318**	**1.980**	**2.436**
Fallsifikim	533	553	643
Mashtrim	563	546	393
Krime të pronës	**6.053**	**8.365**	**8.233**
Vjedhje me dhunë	269	251	157
Vjedhje banese	1.277	1.657	1.387
Vjedhje lokale tregëtie	895	793	719
Krime në fushën e pastrimit të parasë	**125**	**326**	**355**
Pastrimi i produkteve	87	206	266
Krime të tjera	**9.753**	**14.501**	**18.005**
Dhuna në familje	**3.020**	**4.121**	**3.448**
Shkelje rregullave të qarkullimit rrugor	**2.987**	**4.315**	**5.280**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

DHUNA NË FAMILJE, 2013-2015

	2013	2014	2015
Raste të evidentuara nga policia	3.020	4.121	3.448
Nga të cilët të vdekur	28	22	20
Kërkesa për urdhër mbrojtje	1.851	2.422	2.148
Autorët	2.951	3.991	3.534

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara bëjnë fjalë për vepra të regjistruara nga policia, për ngjarje të ndodhura, jo për gjykime të cilat janë në kompetencë të organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin.

Në vitin 2015 janë evidentuar 30.584 krime, rreth 13,6 % më shumë se në vitin 2014. Ndër grupveprat kryesore penale, "Krimet seksuale" kanë pësuar një rritje të ndjeshme prej rreth 41 %, krahasuar me vitin 2014. Rritje të konsiderueshme kanë pësuar edhe grupveprat "Krime ekonomike-financiare" me 23 % dhe "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" me 22 % më shumë krime të evidentuara.

Ndër vite, numri i raportimeve të dhunës në familje ka qënë në rritje, ndërkohë viti 2015 shënon rënie në numrin e tyre. Krahasuar me vitin 2014 kemi 16,3 % raportime më pak, ose shprehur në terma absolut në vitin 2015 kemi 673 raportime më pak.

Në vitin 2015 si rezultat i dhunës në familje janë regjistruar 20 vdekje, 2 më pak se në vitin 2014.

Në vitin 2015 janë evidentuar rreth 41 % më shumë krime seksuale krahasuar me vitin 2014.

12 Statistika Juridike

Në vitin 2015 janë dënuar 16.141 persona, 96 % e të cilëve janë persona të rritur (mbi 18 vjeç). Krahasuar me vitin 2014, ky vit shënon një rritje prej 18,5 % persona të dënuar. Numri i personave të dënuar mbi 18 vjeç është rritur me 21 %, ndërsa numri i të miturve të dënuar është ulur me 22 %.
Nga tabela vihet re se në vitin 2015 numri i femrave të dënuara është dyfishuar krahasuar me vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 janë burgosur 6.128 persona, ku përfshihen si të paraburgosurit dhe të dënuarit me burg. Ky vit ka shënuar një rritje prej 12,4 % në numrin e të burgosurve krahasuar me vitin 2014. Nëse flasim vetëm për të dënuarit me burg, gjatë vitit 2015 numërohen 2.985 persona të burgosur, rreth 5 % më shumë krahasuar me vitin 2014.

Vepra penale "Vrasje" shënon numrin më të madh të të burgosurve për vitin 2015, ndjekur nga veprat "Krime në fushën e drogës" dhe "Vjedhjet".

Përqindjen më të madhe të të burgosurve e zënë personat e dënuar për Vrasje me 24 % të totalit të të burgosurve.

TË DËNUARIT SIPAS 2 NDARJEVE TË MËDHA MOSHORE

	2013	2014	2015
Gjithsej	**8.577**	**13.618**	**16.141**
Të dënuar të rritur	**7.897**	**12.845**	**15.540**
Meshkuj	7.562	12.452	14.670
Femra	335	393	870
Të dënuar të mitur	**680**	**773**	**601**
Meshkuj	677	765	590
Femra	3	8	11

Burimi: Ministria e Drejtësisë

TË DËNUARIT ME BURG SIPAS GJINISË DHE GRUPMOSHËS

	2013	2014	2015
Gjithsej	**2.942**	**2.838**	**2.985**
Meshkuj			
Të burgosur të rritur	2.865	2.788	2.912
Të burgosur të mitur	19	9	13
Femra			
Të burgosur të rritur	58	41	60
Të burgosur të mitur	0	0	0


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

TË BURGOSURIT SIPAS VEPRAVE PENALE

Vepra penale	2014	2015
Gjithsej	**5.453**	**6.128**
Vjedhje	1.491	1.212
Vrasje	1.342	1.470
Plagosje	186	218
Marrëdhënie seksuale me dhunë	112	134
Krime në fushën e drogës	1.142	1.329
Organizata kriminale	17	28
Mashtrim	74	68
Shfrytëzim prostitucioni	93	79
Të tjera	996	1.590


Shënim: Të burgosur deri në 31 dhjetor
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

PËRBËRJA E PARLAMENTIT NË %



*Nr i deputetëve deri në fund të vitit 2015
Burimi: Kuvendi

DEPUTETE FEMRA NË PARLAMENT SIPAS PARTIVE POLITIKE, 2015



Burimi: Kuvendi

Sipas të dhënave nga Parlamenti i Shqipërisë, gjatë periudhës 2001-2009, pjesëmarrjen më të madhe e kanë pasur deputetët meshkuj.

Në zgjedhjet Parlamentare të vitit 2009, pjesëmarrja e grave në parlament u rrit me më shumë sesa dyfishi nga 7 % e cila ishte në periudhën 2005-2009 në 16 % për periudhën 2009-2013. Tendenca në rritje vihet re edhe në zgjedhjet parlamentare 2013 ku arriti në 18 %. Kjo tendencë ka vazhduar, ku në fund të vitit 2015 pjesmarrja e deputeteve femra është 23 %.

Nga numri total i femrave deputete në parlament 50 % e tyre janë deputete të Partisë Socialiste, 34 % të Partisë Demokratike, 13 % të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe 3 % nga Partia Kristiandemokrate.

Shkalla e pjesëmarrjes së femrave në Parlamentin Shqiptar nga viti 2001 deri në fund të vitit 2015 është rritur 3,6 herë.

14 Vendimmarrja


Sipas të dhënave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zgjedhjet vendore 2015, shkalla e suksesit për kandidatet për kryetare bashkie femra është më e lartë se tek kandidatët meshkuj. Nga 142 meshkuj Kandidatë për kryetar bashkie, kanë fituar 52 ose 37 %. Ndërkohë për sa i përket kandidateve për kryetar bashkie femra, nga 16 kandidatë kanë fituar 9, ose 56 %.

Nga ana tjetër kandidatët meshkuj për këshilltar bashkiak kanë qenë 2 herë më të suksesshëm sesa kandidatet femra. Përqindja e fituesve nga të gjithë kanditatët meshkuj në zgjedhjet e 2015 ishte 6 %, ndërsa për femrat 3 %.

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE PËR KËSHILLIN BASHKIAK, 2015


Zgjedhjet vendore, 2015	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Kandidatë për Kryetar Bashkie	142	16	158
Fitues Kryetar Bashkie	52	9	61
Kandidatë për Këshillat Bashkiak	18.404	17.937	36.341
Fitues Këshilltarë	1.040	555	1.595

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE PËR KËSHILLIN BASHKIAK, 2015



Nga zgjedhjet vendore 2015, 15% e bashkive drejtohen nga kryetare femra.

PJESËMARRJA NË ARSIM (GER)



RAPORTI NXËNËS PËR MËSUES

Arsimi	2013-14	2014-15	2015-16
Në arsimin publik			
9 vjeçar cikli i ulët	19,1	18,9	18,3
Qytet	25,4	25,0	24,0
Fshat	15,2	14,9	14,8
9 vjeçar cikli i lartë	12,6	12,2	11,1
Qytet	15,2	14,9	13,4
Fshat	10,7	10,3	9,4
I mesëm	17,0	16,2	15,0
Qytet	17,2	16,9	15,6
Fshat	16,4	14,5	13,8
Në arsimin privat			
9 vjeçar cikli i ulët	16,0	15,3	16,4
Qytet	15,9	15,1	16,3
Fshat	17,9	18,1	17,4
9 vjeçar cikli i lartë	8,8	8,3	7,8
Qytet	8,8	8,2	7,8
Fshat	8,1	9,6	8,1
I mesëm	9,7	9,1	8,2
Qytet	9,3	9,9	8,4
Fshat	n.a.	3,4	6,5

Popullsia që merr pjesë në arsimin parauniversitar paraqitet në rritje të vazhdueshme në të tre nivelet arsimore. Treguesit kryesorë që masin pjesëmarrjen në nivelet e ndryshme të arsimit janë raporti bruto dhe neto i regjistrimit. Në arsimin fillor këto dy tregues janë të lartë, pavarësisht se dihet që ekziston në disa raste fenomeni i braktisjes. Treguesi i raportit neto të regjistrimeve merr vit pas viti vlera rritëse. Kjo tregon që ndjekin shkollën pa ndërprerje dhe në kohën e duhur më tepër nxënës sipas këtyre niveleve. Ky raport është rritur në mënyrë të vazhdueshme në ciklin e lartë të arsimit 9 vjeçar dhe më dukshëm në arsimin e mesëm. Në të dy vitet e fundit raporti neto i regjistrimeve në arsimin e mesëm është 75 %, cili është edhe raporti më i mirë i arritur për këtë nivel arsimor.

Nxënësit e regjistruar në arsimin privat 9 vjeçar përbëjnë 6,1 %, ndërsa në atë të mesëm përbëjnë 10,3 %.

Një tregues që ndikon cilësinë e proçesit arsimor është raporti i nxënësve për një mësues, i cili në arsimin publik ka arritur nivelin më të mirë në vitin 2015 për të dy ciklet e arsimit 9 vjeçar. Numri i nxënësve për një mësues në arsimin publik fillor varion nga 19.1 që ishte në vitin 2013 në 18.3 në vitin 2015, nga 12.6 në 11.1 në ciklin e lartë të 9 vjeçares dhe nga 17 në 15 nxënës për një mësues në arsimin e mesëm, krahasuar vitet si më lart Ndonëse ky raport ulet nga viti në vit, ai mbetet ende i lartë krahasuar me shumicën e vendeve europiane. Në arsimin privat në të dy ciklet raporti është akoma në vlera të pranueshme.

Në vitin 2015-16 është ulur numri i nxënësve për mësues sidomos në arsimin parauniversitar publik

16 Arsimi dhe Njohuritë

Shkalla e diplomimit në arsimin e mesëm ka një rritje të dukshme në dy vitet e fundit 2014, 2015. Por pavarësisht nga kjo, në këto dy vite diplomohen nxënës më pak se vitet e mëparshme, gjë e cila lidhet kryesisht me rënien e lindshmërisë. Në vitin e fundit 12 % e të diplomuarve të arsimit të mesëm i përkasin arsimit profesional.

Numri i studentëve të diplomuar në arsimin e lartë, në vitin 2015 është 4.392 më shumë se viti paraardhës. Ndër të diplomuarit mbizotërojnë gjithmonë ato me diplomë bachelor prej 57,1 % në 2015, megjithëse duhet theksuar që të diplomuarit me master janë rritur vit pas viti.

Të diplomuarit e arsimit të lartë janë ndarë sipas 10 fushave të gjera të studimit, të përcaktuar sipas Manualit ISCED F-2013, i cili i bën këta të krahasueshëm në shkallë ndërkombëtare. Të diplomuarit e vitit 2015 i përkasin në shumicën e tyre fushës së biznesit administrimit dhe ligjit prej 29,2 % dhe përqindjen më të vogël e mbajnë ato të diplomuar në fushën e shërbimeve prej 2,3 %, siç shihet dhe nga grafiku.


Në përpunimin e të dhënave dhe llogaritjen e indikatorëve të arsimit INSTAT përdor klasifikimin ISCED 2011.

Numri i studentëve të diplomuar në arsimin e lartë në vitin 2015 është 4.392 më shumë se në vitin 2014.


NUMRI I TË DIPLOMUARVE NË ARSIM

Të Diplomuar	2012-13	2013-14	2014-15
9 vjeçar	47.819	44.139	44.001
Të mesëm	45.899	35.254	39.629
Profesional	4.322	3.136	4.702
Pas të mesme jo të lartë	145	164	125
Të diplomuar në Arsimin e Lartë	30.365	29.137	33.529
vetëm Bachelor	20.351	17.469	19.152

SHKALLA DIPLOMIMIT NË ARSIMIN E MESËM



STUDENTË TË DIPLOMUAR SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT , VITI 2015 NË %



Shënim: Sipas manualit të fushave të studimit, ISCED - F 2013

PËRDORIMI I TELEFONISË DHE RRJETEVE BROADBAND TË INTERNETIT

	Njësia	2013	2014	2015
Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse	për 100 pers.	10	9	8
Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare		127	116	118
Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur broadband 3G nga aparate celulare		39	27*	41
Numri i lidhjeve broadband nga rrjete fikse		6	7	8
Thirrje telefonike dalëse të gjeneruara nga përdoruesit e telefonisë celulare	milion minuta	6.769	7.301	7.409
Numri i SMS të gjeneruara	milion mesazhe	1.689	1.826	1.599

Burimi: Autoriteti i komunikimeve telefonike dhe celulare, Raporti vjetor 2015

Sipas të dhënave të Autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare ka një rënie në vazhdim të numrit të përdoruesve aktivë të telefonisë fikse edhe për 2015. Nga ana tjetër numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare është rritur edhe në 2015, me më shumë se 1 %. Për më tepër, për sa i përket numrit të minutave të thirrjeve telefonike dalëse nga përdoruesit e telefonisë celulare, rritja duket e vazhdueshme.

Kjo rritje duket se vazhdon pavarësisht luhatjeve në numrin e përdoruesve aktivë të telefonisë celulare. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për numrin e SMS-ve të gjeneruara, pasi ka pasur një rënie të tyre në 2015. Gjatë periudhës 2013-2015 ka pasur rritje të numrit të lidhjeve broadband nga rrjete fikse. Për shkak të ndryshime në mënyrën e raportimit të përdoruesve të rrjeteve bradband nga aparate celulare, ka pasur një rishikim të numrit të tyre për 2014. Megjithatë një trend i përgjithshëm rritës vërehet edhe për këtë indikator.

Në vitin 2015 numri pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse u rrit me rreth 35 mijë në krahasim me vitin 2014, çka përbën një rritje vjetore prej 17 %.

18 Kultura

Të dhënat nga Biblioteka Kombëtare tregojnë se numri i faqeve të dixhitalizuara është rritur afërsisht 18 herë në periudhën 2013-2015. Ndërkohë numri i botimeve/përkthimeve të mbështetura nga Ministria e Kulturës është rritur me 4 herë në periudhën 2013-2015.

Numri i shfaqjeve në institucionet qendrore të artit është rritur 4 herë për të njejtën periudhë dhe e njejta tendencë paraqitet dhe për numrin e spektatorëve.


Për sa i përket Galerisë së Arteve, numri i vizitorëve në periudhën 2013-2015 është rritur me 1,4 herë, ndërkohë numri i ekspozitave për të njejtën periudhë është rritur 2 herë.

Trendi rritës vihet re dhe për trashëgiminë kulturore. Sipas të dhënave për numrin e vizitorëve të vitit 2015, parqet arkeologjike frekuentohen më së shumti nga vizitorët (45 % e vizitorëve), më pas renditen muzetë (29 % e vizitorëve) dhe të fundit renditen kalatë e monumente të tjera (26 % e vizitorëve).

INSTITUCIONE TË KULTURËS DHE ARTIT 2013-2015


	2013	2014	2015
Biblioteka Kombëtare			
Abonentë në BK	5.588	6.316	6.382
Numri i vizitorëve (ekspozita/vizita) në BK	4.600	4.901	27.877
Numri i frekuentuesve në sallat e leximit	193.039	195.138	207.924
Numri i teksteve të dixhitalizuara nga BK (faqe)	5.884	31.924	107.704
Numri i botimeve /përkthimeve të mbështetura nga MK	13	38	49
Institucionet qëndrore të artit			
Numri i shfaqjeve	201	283	869
Numri i premierave	8	29	70
Numri i spektatorëve	39.248	66.517	149.586
Galeria e Arteve			
Numri i ekspozitave	13	20	26
Numri i vizitorëve	22.350	24.715	30.641
Trashëgimia kulturore			
Numri i vizitorëve në parqet arkeologjike	121.836	175.472	209.547
Numri i vizitorëve në muze	161.183	135.578	131.808
Numri I vizitorëve në kala e monumente të tjerë	42.786	93.194	119.389

SHPËRNDARJA E VIZITOREVE NË TRASHËGIMINË KULTURORE



Numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare është rritur afërsisht 7 % nga viti 2014 në 2015.

SHKALLA E PAPUNËSISË



Shkalla e papunësisë në Shqipëri mbetet në nivel dy shifror si për femrat ashtu dhe për meshkujt. Në tregun shqiptar të punës të rinjtë e moshës 15-29 vjeç kanë mesatarisht 2,5 herë më shumë gjasa se popullsia adulte e moshës 30-64 vjeç që të jenë të papunë.
Kështu, në vitin 2015, shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ishte 33,2 %, ndërkohë që shkalla e papunësisë për po-pullsinë 30-64 vjeç ishte 12,5 %.

Përqindja e të rinjve në moshë 15-29 vjeç të cilët janë jo në punësim e as duke ndjekur shkollën apo ndonjë trajnim profesional është 32,8 %.

PAPUNËSIA

	Njësia	2013	2014	2015
Të papunë	1 000	**194**	**220**	**224**
Meshkuj	-	122	139	128
Femra	-	72	81	96
Shkalla e papunësisë	përqindje	**15,9**	**17,5**	**17,1**

Burimi: Anketa e Forcave të Punës 2013-2015

SHKALLA E PAPUNËSISË
Të papunët si përqindje ndaj totalit të forcave të punës.
PAPUNËSIA
Personat 15-74 vjeç të cilët në një periudhë të caktuar reference plotësojnë njëkohësisht të tre kriteret si më poshtë: nuk kishin një punë, ishin duke kërkuar punë aktivisht, dhe ishin të gatshëm që në rast se gjenin një punë të fillonin punë (të papunë në përputhje me definicionin e ILO-s).

Gjatë vitit 2015, gjashtë në dhjetë persona të papunë po kërkonin punë për herë të parë në tregun e punës.


Punësimi gjithsej në Shqipëri dominohet nga sektori bujqësor dhe nga sektori i shërbimeve (me peshë përkatësisht 41,3 % dhe 39,9 % ndaj totalit në vitin 2015).

Tregu i punës në Shqipëri karakterizohet nga një hendek gjinor relativisht i konsiderueshëm dhe i vazhdueshëm në kohë në shkallën e punësimit, e cila rezulton më e lartë te meshkujt se sa tek femrat. Diferenca ndërmjet shkallës së punësimit të meshkujve dhe femrave në vitin 2015 ishte 15 pikë përqindje.

Femrat kanë pothuajse 1,8 herë më shumë gjasa sesa meshkujt për të qenë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes (39,8 % e femrave të punësuara dhe 22,3 % e meshkujve të punësuar ishin punëtorë pa pagesë të familjes në vitin 2015).

FORCAT E PUNËS
Shuma e personave të punësuar dhe të papunë në moshë 15 vjeç e lart.

SHKALLA E PUNËSIMIT



STATUSI NË LIDHJE ME PUNËSIMIN E POPULLSISË

	Njësia	2013	2014	2015
Popullsia gjithsej	1 000	**2.897**	**2.894**	**2.889**
Forcat e punës gjithsej	-	**1.218**	**1.257**	**1.310**
Meshkuj	-	685	725	748
Femra	-	533	532	562
Të punësuar gjithsej	-	**1.024**	**1.037**	**1.087**
Meshkuj	-	563	586	621
Femra	-	461	451	466
Shkalla e punësimit*	përqindje	**49,9**	**50,5**	**52,9**
Meshkuj	-	57,3	58,0	60,5
Femra	-	43,1	43,4	45,5

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2015

*) Ilogaritur mbi popullsinë 15-64 vjeç

Në vitin 2015 përqindja e punësimit informal në sektorin jo-bujqësor është 34,1%. Krahasuar me vitin 2014, punësimi informal në sektorin jo-bujqësor pësoi një rënie prej 5,3 pikë përqindje.

NJEF SIPAS LLOJIT TË BANESËS, VITI 2014

Lloji i banesës	NjEF në %
Shtëpi për një familje	78,3
Banesë në një ndërtesë me deri 15 apartamente	10,8
Banesë në një ndërtesë me më shumë se 15 apartamente	10,1
Tjetër	0,8

NJEF SIPAS SIPËRFAQES SË PËRDORUR TË BANESËS, VITI 2014

Sipërfaqja e banesës	NjEF në %
Më pak se 50 m^2	7,8
51-90 m^2	49,8
91-130 m^2	33,3
Më shumë se 130 m^2	9,1

NJEF SIPAS STATUSIT TË PRONËSISË SË BANESËS, VITI 2014

Statusi i pronësisë	NjEF në %
Pronar ose duke u bërë pronar (ka marrë hua, kredi ose në pritje të legalizimit)	94,0
Me qira (nga një person privat ose nga shteti)	4,1
Jeton falas/e ka në përdorim/tjetër	1,9

Sipas Anketës së Buxhetit të Familjes 2014, më shumë se 78 % e Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) jetojnë në një shtëpi të vetme. NjEF të cilat jetojnë në banesa që janë pjesë të ndërtesave me 15 apartamente zënë 10,8 % ndërsa banesa që janë pjesë të ndërtesave me 15 apo më shumë apartamente zënë 10,1 % të NjEF në Shqipëri.

Banesat me sipërfaqe deri në 90 metra katrorë zënë peshën më të madhe të të gjithë banesave, 57,6 % në vitin 2014. Banesat me sipërfaqe 91-130 metra katrorë renditen në vendin e dytë përsa i përket shpërndarjes, me 33,3 %

Pjesa më e madhe e banesave janë në pronësi të familjeve, 94 %. Përsa i përket kategorive të tjera, ato zënë një përqindje shumë të vogël të banesave ku NjEF jetojnë në banesa të marra me qira ose falas, 4,1 % dhe 1,9 %.

Në familjet që banojnë në banesa për qëllime banimi 6,2 % e tyre jetojnë në kushte mbipopullimi të cilat kanë një sipërfaqe mesatare rreth 13 metra katrorë për person

Statusi ligjor i pronësisë së banesës sipas grup-moshës së kryefamiljarit tregon se me rritjen e moshës së kryefamijarit rritet edhe mundësia për të patur në pronësi banesën ku NjEF jeton. Vihet re se në grup-moshat nga 36 deri 75 vjeç rritet mundësia për të qënë pronar. Përqindja më e lartë për këtë kategori vihet re për NjEF me kryefamijarë të grup-moshës 56-65 vjeç, 26 %. Përsa i përket NjEF që jetojnë me qira, përqindja më e lartë regjistrohet për NjEF me kryefamiljarë të grup-moshës 36-45 vjeç, 25,4 %.

Ndër pajisjet agfatgjata që NjEF zotërojnë kryesisht janë televizor, frigorifer dhe lavatriçe në përqindjet si në vijim: 97,8 %, 97,1 % dhe 87,4 %. Vetëm 24,7 % e NjEF në Shqipëri zotërojnë të paktën një autoveturë. Vlerat më të ulta në përqindje të zotërimit të pajisjeve afatgjata të NjEF janë për kondicionerë, 16,2 %, makinë qepëse/endëse, 11,0 % dhe makinë larëse enësh, 4,9 %.

NjEF SIPAS GRUP-MOSHËS SË KRYEFAMILJARIT DHE STATUSIT LIGJOR TË PRONËSISË SË BANESËS, VITI 2014

%


Grup-mosha e kryefamiljarit	Statusi ligjor i pronësisë së banesës			
	Pronar ose duke u bërë pronar	Me qira	Jeton falas, e ka në përdorim, tjetër	Gjithsej
Më pak se 25 vjeç	0,3	13,5	1,4	0,9
25-35 vjeç	6,6	20,6	22,0	7,5
36-45 vjeç	15,7	25,4	20,7	16,2
46-55 vjeç	25,4	20,2	31,9	25,3
56-65 vjeç	26,0	9,5	12,8	25,1
66-75 vjeç	17,8	7,1	4,9	17,1
Më shumë se 75 vjeç	8,2	3,7	6,3	8,0

NjEF SIPAS ZOTËRIMIT TË PAJISJEVE AFATGJATA KRYESORE, VITI 2014


Pajisjet afatgjata kryesore	NjEF në %
Televizor	97,8
Frigorifer	97,1
Lavatriçe	87,4
Sobë elektrike dhe/ose me gaz	86,0
Sobë me dru dhe/ose me qymyr	58,7
Autoveturë	24,7
Kondicioner	16,2
Makinë qepëse/endëse	11,0
Makinë larëse enësh	4,9

Ndër NjEF që banojnë në banesa për qëllime banimi, 4,1 % jetojnë në banesa të marra me qira.

PESHAT E IÇK DHE STRUKTURA E ABF SIPAS 12 GRUPEVE KRYESORE TË KONSUMIT



NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I ICK



Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit në vitin 2015 është 1,7 %.

Rritja më e madhe e çmimeve prej 8,7 % vërehet në grupin "Shërbimi arsimor" duke kontribuar me 0,12 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupi "Ushqime dhe pije alkoolike" ka shënuar një rritje prej 3,9 % duke ndikuar me 1,53 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupit "Pije alkolike dhe duhan" ka shënuar një rritje prej 5,3 % me një ndikim prej 0,2 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor.
Ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Transporti" me 2,0 % duke kontribuar me -0,07 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupit "Shëndeti" shënoi një ulje prej 1,9 % me një ndikim prej -0,07 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Ndryshimet mesatare vjetore në grupet e tjera variojnë nga -1,9 % në 6,7 %.

KONSUMI
Statistikat e konsumit janë shumë të rëndësishme për të analizuar zhvillimet socio-ekonomike në vend. Shpenzimet e buxhetit të familjes japin informacion jo vetëm mbi nivelin dhe strukturën e konsumit të familjeve shqiptare, por shërbejnë edhe për të përditësuar IÇK.
Statistikat e Çmimeve të Konsumit luajnë rol kyç në matjen e inflacionit nga konsumatorët.

Në vitin 2015 grupi "Ushqime dhe pije jo alkoolike" kontriboi me 1,53 pikë përqindje në totalin e ndryshimit mesatar vjetor.

24 Regjistri i Ndërmarrjeve

Regjistri statistikor i ndërmarrjeve në fund të vitit 2015 numëron 152.288 ndërmarrje aktive. Ndërmarrjet me aktivitet ekonomik "Tregti" përfaqësojnë 35,3 % të ndërmarrjeve gjithsej, ndërsa aktiviteti ekonomik "Informacion dhe komunikacion" përfaqëson vetëm 1,6 %.

Ndërmarrjet me formë ligjore "Person fizik" mbizotërojnë në ekonominë shqiptare nga të cilat 43 % ushtrojnë aktivitetin ekonomik në fushën e tregtisë.

Gjatë vitit 2015 e në vazhdim pranë drejtorive rajonale tatimore po regjistrohen edhe fermerët, për arsye të përfshirjes në skemën e kompensimit të TVSH-së.

REGJISTRI STATISTIKOR I NDËRMARRJEVE përmban të gjitha njësitë ligjore që janë regjistruar pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) apo edhe pranë organeve tatimore. Këto njësi janë të pajisura me numër identifikimi NIPT dhe ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Regjistri statistikor i ndërmarrjeve përditësohet me burime administrative dhe vrojtime statistikore.

Në regjistrin statistikor të ndërmarrjeve 2015 janë përfshirë edhe 19.534 ferma.


NDËRMARRJET AKTIVE SIPAS FORMËS LIGJORE, VITI 2015

Forma ligjore	Nd. Aktive
Gjithsej	**152.288**
Fermerë	19.543
Persona Fizikë	103.414
Persona Juridikë	29.331
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	23.643
Shoqëri Aksionare	911
Ndërmarrje Shtetërore	935
Administrata Publike	498
OJF, Org. ndërkombëtare	2.410
Shoqëri të tjera	934


NDËRMARRJET AKTIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK, VITI 2013-2015

Aktiviteti ekonomik	2013	2014	2015
Gjithsej	**111.083**	**112.537**	**152.288**
Bujqësia, pyjet, peshkimi	1.690	2.260	21.194
Industria	10.333	10.154	11.810
Ndërtimi	4.819	4.575	4.946
Tregtia	44.878	44.969	53.699
Transporti dhe magazinimi	8.024	7.562	7.008
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.825	18.061	23.186
Informacioni dhe komunikacioni	2.495	2.590	2.453
Shërbime të tjera	21.019	22.366	27.992

NDËRMARRJET AKTIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK, VITI 2015



INDEKSI I TREGTISË ME PAKICË PËR PRODUKTET USHQIMORE DHE JO USHQIMORE NË NJËSI TREGTARE TË SPECIALIZUARA DHE JO TË SPECIALIZUARA



INDEKSET E VOLUMIT NË TREGTINË ME PAKICË DHE TREGTINË ME PAKICË TË HIDROKARBUREVE

2010=100

NACE	Aktiviteti ekonomik	2013	2014	2015
47	**Tregti me Pakicë**	**118,6**	**124,6**	**131,4**
47 pa 473	**Tregti me Pakicë (pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)**	**103,0**	**108,3**	**119,9**
4711	Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara	86,0	100,3	122,1
4719	Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara	98,6	85,0	89,7
472	Ushqime pije e duhan në njësi tregtare të specializuara.	115,6	102,4	90,2
474	Pajisje kompjuterike, informatike dhe te konukacionit	129,7	132,9	135,8
475	Paisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake	130,9	133,1	132,7
476	Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimt, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara	96,1	105,2	120,3
4771-4772	Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure	103,8	124,3	144,7
4773-4775	Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjenës personale	126,8	141,7	169,2
4776-4778	Atikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura	40,8	51,3	61,9
473	**Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara**	**162,5**	**170,6**	**166,2**

Indeksi në volum i Tregtisë me Pakicë në vitin 2015 ka shënuar një rritje me 5,4 % krahasuar me vitin 2014. Nëngrupet kryesore të saj kanë patur një ritëm rritje përkatësisht 10,7 % në nëngrupin "Tregti me Pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara", 9,1 % në nëngrupin "Artikujt jo ushqimor në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara" dhe 14,1 % në nëngrupin "Produktet ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara".

Ndërkaq, referuar ecurisë ndër vite të ritmit të rritjes të dy nëngrupeve "Produkte ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara" dhe "Artikuj jo ushqimor në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara" mund të themi se: Nga viti 2005-2010, vihet re një ritëm rritje mesatar më i madh i nëngrupit të parë, dhe nga viti 2011-2015 kjo situatë përmbyset dhe ritmin mesatar të rritjes më të madhe e zëvendëson nëngrupi i dytë.

Indeksi në volum i Tregtisë me Pakicë mat ecurinë mujore të shitjeve, të vlerësuara me çmimet aktuale, në njësitë ekonomike të cilat kryejnë veprimtari të tregëtimit me pakicë të produkteve ushqimore, artikujve jo ushqimorë dhe hidrokarbureve. Indekset e nëngrupeve janë deflatuar me çmimet e konsumit të nëngrupeve përkatëse.

Në vitin 2015 kontributin më të madh në indeksin në volum të Tregtisë me Pakicë e ka dhënë nëngrupi "Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara", me 3,3 pikë përqindje.

Në vitin 2015 volumi tregtar i mallrave është ulur me 2,5 % krahasuar me 2014, duke patur një rënie vjetore për eksportet rreth 4,9 % dhe 1,4 % për importet.

Grupet më të rëndësishme të mallrave që eksporton Shqipëria janë: "Produktet minerale" dhe "Tekstile dhe artikuj tekstile". Në vitin 2015 këto grupe kanë zëne respektivisht 26,5 % dhe 18,9 % të eksporteve gjithsej.


Grupet më të rëndësishme të mallrave që importon Shqipëria janë: "Makineri e pajisje mekanike dhe elektrike" dhe "Produktet minerale". Në vitin 2015 këto grupe kanë zëne respektivisht 15,1 % dhe 11,0 % të importeve gjithsej.

Dy nga partnerët kryesorë si për eksportet, ashtu edhe për importet për vitin 2015, janë Italia dhe Greqia, duke zënë rreth 54,8 % të eksporteve shqiptare dhe 38,1 % të importeve shqiptare.

Bilanci tregtar është diferenca ndërmjet vlerës së mallrave që një vend eksporton dhe vlerës së mallrave që një vend importon.

Në vitin 2015 Kosova është partneri i dytë kryesor përsa i përket eksporteve duke zënë rreth 8,6 % të eksporteve shqiptare.

TREGTIA E JASHTME DHE BILANCI TREGTAR I MALLRAVE



** 2013 Gjysëm-finale*
***2014 Paraprake*
^ Seria 1996-2007 nuk reflekton rishikimet e reja

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE


milion lekë

	1995	2000	2005	2010	2015
Eksporte (FOB)	18.710	37.037	65.818	161.548	243.183
Importe (CIF)	66.147	157.109	262.191	477.768	544.588
Bilanci tregtar (Eksporte-importe)	-47.437	-120.072	-196.373	-316.220	-301.405
Volumi tregtar (Eksporte+Importe)	84.857	194.146	328.009	639.315	787.771
Përqindja e mbulimit (%)	28,3	23,6	25,1	33,8	44,7

PESË PARTNERËT KRYESORË TREGTARË, 2015

	Eksportet			Importet	
	milion lekë	% ndaj gjithsej		milion lekë	% ndaj gjithsej
Itali	123.703	50,9	Itali	164.990	30,3
Kosovë	20.921	8,6	Kinë	46.567	8,6
Spanjë	12.607	5,2	Turqi	43.722	8,0
Maltë	11.209	4,6	Greqi	42.718	7,8
Greqi	9.511	3,9	Gjermani	36.349	6,7

NUMRI I PASAGJERËVE QË UDHËTOJNË ME MJETE TË TRANSPORTIT DETAR, AJROR DHE HEKURUDHOR



LËVIZJA E MALLRAVE SIPAS MËNYRËS SË TRANSPORTIT, 2015

	Eksportet		Importet	
	milion lekë	% ndaj gjithsej	milion lekë	% ndaj gjithsej
Gjithsej	**243.183**	**100,0**	**544.588**	**100,0**
Transporti detar	164.305	67,6	280.950	51,6
Transporti rrugor	73.444	30,2	220.304	40,5
Transporti ajror	1.095	0,5	20.916	3,8
Mënyra të tjera transporti	4.340	1,8	22.417	4,1

Në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, numri mesatar i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat detare është rritur me 8,4 %; i pasagjereve që udhëtojnë me linjat ajrore me 9,2 % dhe numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat hekurudhore është rritur mesatarisht me 1,6 %.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër, në vitin 2015, zë mesatarisht 59,0 % të numrit të pasagjerëve gjithsej që udhëtojnë me (det, ajër dhe hekurudhë), i ndjekur nga numri i pasagjerëve që udhëtojnë me det me 35,4 % dhe i pasagjerëve që udhëtojnë me hekurudhë me 5,7 %.

Në vitin 2015 mallrat e transportuara nëpërmjet detit zënë rreth 67,6 % të eksporteve shqiptare dhe rreth 51,6 % të importeve shqiptare


Rreth 56,5 % e volumit tregtar të mallrave në vitin 2015 janë transportuar me det, ndërsa numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër zë më shumë se gjysmën e numrit të pasagjerëve gjithsej (59.0 %).

Hyrjet e shtetasve të huaj në pikat kufitare për vitin 2015 janë rritur me 12,5 %, ndërkaq daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur me 8,6 %, krahasuar me vitin 2014.

Gjatë vitit 2015, hyrjet e shtetasve të huaj nga rajoni i Evropës zënë pjesen më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej me 90,7 %. Evropa Jugore zë përqindjen më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj me 84,1% të hyrjeve gjithsej nga Evropa. Hyrjet nga Kosova zënë mesatarisht 53,3 % të hyrjeve të Evropës Jugore, të ndjekura nga hyrjet që vijnë nga Maqedonia me 16,3 % dhe Mali i Zi me 7,6 %

Hyrjet e shtetasve të huaj nga rajonet e tjera zënë mesatarisht 9,3 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej

DALJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE



Turist, quhet një vizitor i cili kalon të paktën një natë në një strukturë hoteliere në vendin që ai viziton.

HYRJET E JO-REZIDENTËVE NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE, SIPAS KOMBËSISË

	2013	2014	2015
Gjithsej	**3.255.988**	**3.672.591**	**4.131.242**
I . Afrika	919	859	4.686
II. Amerika	73.291	90.084	107.080
III. Azia Lindore dhe Paqësori	23.628	30.874	33.032
IV. Lindja e Mesme	3.944	2.607	3.604
V. Azia e Jugut	961	1.274	1.636
VI. Evropa	2.963.583	3.423.665	3.747.457
Evropa Qëndrore / Lindore	112.333	163.006	151.457
- Evropa Veriore	119.016	137.308	130.352
- Evropa Jugore	2.467.195	2.821.920	3.152.369
- Evropa Perëndimore	210.845	237.760	246.811
- Evropa Lindore / Mesdheut	54.194	63.671	66.468
VII. Rajone të paspecifikuara	189.662	123.228	233.747

Hyrjet e shtetasve të huaj gjatë vitit 2015 nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi zënë mesatarisht 59,0 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.

LLOGARITË KOMBËTARE


	Njësia	2013*	2014**	2015***
PBB(me çmime korrente)	Mln lekë	**1.350.555**	**1.400.549**	**1.442.956**
Burimet(me çmime konstante)	Mln lekë			
PBB	-	1.347.640	1.377.858	1.437.054
Importet e mallrave e shërbimev e (fob)	-	727.479	662.991	620.644
Përdorimet(me çmime konstante)	-			
Eksportet e mallrave e shërbimev e (fob)	-	479.581	394.924	393.486
Konsumi Final i Popullatës	-	1.046.562	1.080.309	1.103.277
Konsumi Final i Administratës Publike dhe i Institucioneve Jo-fitimprurëse	-	150.981	160.626	157.785
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	-	345.780	336.419	381.540
Ndryshimet e gjendjeve dhe mospërputhje statistikore	-	52.216	68.570	21.610
Rritja reale vjetore e PBB	%	**1,11**	**2,02**	**2,61**
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	1.000 lekë	466	484	499
	Euro	3.323	3.457	3.574
	USD	4.411	4.587	3.965

2013* Të dhëna gjysëm finale

2014** Të dhëna paraprake

2015*** Të dhëna paraprake bazuar mbi vlerësimet tremujore

PRODUKTI I BRENDSHEM BRUTO



Gjatë vitit 2015 ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej +2,61 % krahasuar me vitin 2014, bazuar kjo mbi vlerësimet paraprake tremujore. Konsumi final përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 87,39 % dhe u ul me -0,50 % në terma reale.

Formimi bruto i kapitalit fiks u rrit me +11,27 % në terma reale krahasuar me vitin 2014. Eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve janë ulur në terma reale me përkatësisht -0,04 % dhe -5,75 % krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë në vitin 2015 arriti në 499 mijë lekë.

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

PBB përfaqëson vlerën totale në para të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifke nga njësitë prodhuese rezidente brenda territorit ekonomik të një vendi. Metodat e përdorura në Shqipëri për llogaritjen e PBB janë metoda e prodhimit dhe e shpenzimeve.

PBB për frymë e Shqipërisë e shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse është pothuajse sa një e treta e mesatares së PBB për frymë të vendeve të BE (BE 28 = 100).

Tirazhi 500 kopje